

VENDIM
Nr. 441, datë 31.7.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS KTHESA E
PASHALLISË–KONIZBALTË DERI NË KONIZBALTË”, BASHKIA DIMAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës kthesa e Pashallisë–Konizbaltë deri në Konizbaltë”, Bashkia Dimal.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Dimal.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 489 372.10 (katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy pikë dhjetë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 489 372.10 (katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy pikë dhjetë) lekësh, përballohet nga Bashkia Dimal.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Dimal.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Dimal.
8. Bashkia Dimal kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Dimal.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Dimal për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Dimal për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Dimal, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE, E TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS KTHESA PASHALLISË–KONZIBALTË DERI NË KONIZBALTË”, BASHKIA DIMAL

NR.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	“Arë” (m ²)	“Truall” (m ²)	“Ndërtesë” (m ²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera(lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	
1	Andrea	Dude	Çepele	2075	535/20	arë	240	240			1	59	31.00	203.00	6,293.00	6,293.00	
2	Llambi	Bani	Nano	2075	535/19	arë	1401	1401			1	58	54.00	203.00	10,962.00	10,962.00	
3	Vangjel	Llazi	Kumaraku	2075	535/18	arë	4449	4449			1	57	463.80	203.00	94,151.40	94,151.40	
4	Robert	Stavri	Strori	2075	535/17	arë	3424	3424			1	56	256.00	203.00	51,968.00	51,968.00	
5	Sotirag	Stavri	Strori	2075	535/16	arë	1630	1630			1	55	96.00	203.00	19,488.00	19,488.00	
6	Kristo	Stavri	Strori	2075	535/15	arë	1472	1472			1	54	127.00	203.00	25,781.00	25,781.00	
7	Stavri	Kristo	Strori	2075	535/30	arë	100	100			6	93	100.00	203.00	20,300.00	20,300.00	
	Kostandina	Andon	Strori														
8	Kristo	Stavri	Strori	2075	535/12	arë	1930	1930			1	51	165.00	203.00	33,495.00	33,495.00	
9	Xhevriko	Mesut	Danushi	2075	535/11	arë	1590	1590			1	50	57.00	203.00	11,571.00	11,571.00	
10	Ngjeli	Toli	Komini	2075	535/10	arë	2856	2856			1	49	88.60	203.00	17,985.80	17,985.80	
11	Perparim	Isa	Fisheku	2075	535/28	arë + truall	2740	2540	200	81	6	56	69.70	203.00	14,149.10	14,149.10	
12	Vasil	Jorgji	Naska	2075	535/26	arë	400	400			6	15	58.30	203.00	11,834.90	11,834.90	
13	Llazar	Jorgji	Naska	2075	535/27	arë	2742	2606.1	135.9	135.9	6	16	72.60	203.00	14,737.80	14,737.80	
14	Theodor	Jorgji	Naska	2075	535/5	arë + truall	4475	4275	200		1	44	124.60	203.00	25,293.80	25,293.80	
15	Mina	Llukan	Naska	2075	535/4	arë + truall	3306	3106	200.00	114.00	1	43	119.00	203.00	24,157.00	24,157.00	
16	Fani	Llazar	Çomeni	2075	535/3	arë	2200	2200			1	42	162.00	203.00	32,886.00	32,886.00	
17	Nikollaq	Sotir	Naska	2075	535/2	arë	2495	2495			1	41	133.40	203.00	27,080.20	27,080.20	
18	Vasil	Laske	Garuli	2074	535/1	arë	1864	1864			1	40	117.70	203.00	23,893.10	23,893.10	
19	Arben	Kici	Vogli	2075	539/20	arë	3570	3570			1	158	115.00	203.00	23,345.00	23,345.00	
VLERA TOTALE															489,372.10	489,372.10	